

Nr. 3131 Prot.

VENDIM

NR 43. DATË 29.06.2020

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.105 DATË 22.11.2019 “PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 132, datë 7.3.2018” Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” neni 5.
- Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Neni 22/4, pika b, neni 5 pika b,
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 28.03.2018 pika 1, shkronja ç, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1.1. Miratimin e ndryshimit në Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”, kapitulli I “Taksat Vendore” pika 1.2.1 Taksat mbi ndërtesat, te pjesa e përjashtimeve nga pagesa për taksën e ndërtesës së banimit familjet:

Kategoritë	Falur: Ishte	Falur: Bëhet
Të përndjekurit politik	Po	Jo
Kryefamiljarë me status jetimi	Po	Jo

1.2. **Gërma h, ishte** -Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët ose dhe persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë.

Miratohet të bëhet -Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë

1.3. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.

2.1. Miratimin e ndryshimit në Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”, kapitulli II “Tarifat Vendore” pika II.2



Tarifa	Ishte	Bëhet
Tarifë tregu	50lekë/m ²	35lekë/m ²

2.2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori i biznesit për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.

- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

